

DREJTËSIA RESTAURUESE NË KODIN E DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT

Në drejtësinë penale për të miturit i jepet përparësi masave alternative të shmangies nga procedimi penal. Masat alternative të shmangies i shërbejnë më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit.

Masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale:

- Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi, të cilat mund të përfshijnë pjesëmarrjen në një program të shmangies dhe ndërmjetësimi, të punës në interes publik dhe/ose çdo program tjetër që çon në rehabilitimin e pasojave të veprës penale të kryer nga një i mitur.
- Ndërmjetësimi familjar dhe në grup, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit.

PËRKUFIZIME:

Përkufizime që lidhen me drejtësinë restauruese:

- Drejtësi restauruese konsiderohet çdo program që përdor proceset restauruese dhe që synon të arrijë rezultate restauruese në zgjidhjen e konflikteve. Nëpërmjet një procesi vullnetar, që mbështetet në dialog, negociim dhe që përqendrohet në zgjidhjen e problemit, drejtësia restauruese ka si qëllim të rehabilitojë dhe të riintegrojë individët që kanë kryer kundërvajtje penale, por dhe ata që janë përfshirë në konflikte dhe mosmarrëveshje të natyrës civile, duke i ndihmuar të harmonizojnë qëndrimet dhe sjelljet e tyre me anëtarët e tjerë të komunitetit.
- Ndërmjetësimi, si mundësi alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, i ekspozon palët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit me mënyra paqësore dhe konstruktive të përmirësimit të marrëdhënieve, sidomos të atyre që janë në kontakt të vazhdueshëm me njëri-tjetrin.
- Negocimi është një proces bashkëpunues dhe joformal, me anë të të cilit palët komunikojnë dhe, pa ndonjë ndikim të jashtëm, përpiqen të arrijnë një rezultat që mund t'i kënaqë të dyja palët. Negociatat përdoren gjerësisht në fusha nga më të ndryshmet, të tilla si: marrëdhëniet familjare, mosmarrëveshjet prindërore etj.



Drejtësia Restauruese

Drejtësi sa më Miqësore për Fëmijët

Normat dhe praktika e saj në mjediset shkollore

Modul trajnimi me stafin e shkollave të mesme të përgjithshme mbi zgjidhjen alternative të konflikteve në mjediset shkollore

Eksperte: Enkelejda Ollidashi



Institute for Democracy and Mediation
Institut për Demokraci dhe Ndërmjetësim



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT


ZGJIDHJA ALTERNATIVE E KONFLIKTEVE NË MJEDISET SHKOLLORE

1. Qëndrimi i mësuesit me nxënësit e konfliktuar

- A. Qëndrimi që synon zgjidhjen e problemit.
- B. Qëndrimi që synon arritjen e kompromisit.
- C. Qëndrimi që synon krijimin e situatave paqësore në klasë.
- D. Qëndrimi shpërfillës.

2. Parimet e ndërmjetësimit:

- Ndërmjetësimi është një veprimtari jashtëgryqësore
- Barazia mes palëve
- Vullnetarizmi
- Profesionalizmi
- Ligjshmëria
- Konfidencialiteti
- Proces edukimi i dyanshëm



Veprimet që mund të kryhen nga mësuesit në rastet e shfaqjes së konflikteve në mjediset shkollore:

- Mësuesi duhet të përpiqet t'i bindë fëmijët që ta zgjidhin vetë konfliktin.
- Mësuesi duhet t'i ndajë fëmijët në konflikt dhe për një kohë të caktuar t'i mbajë ata larg njëri-tjetrit.
- Mësuesi duhet të përpiqet të zbulojë shkakun dhe natyrën e konfliktit.
- Mësuesi duhet të përcaktojë vendin dhe rolin e secilës palë (nxënës, grup nxënësish) në çdo konflikt.
- Mësuesi duhet të përpiqet që të gjithë nxënësit e përfshirë në konflikt të ndihen të lehtësuar nga ndërhyrja e tij.
- Mësuesi duhet t'i ndihmojë fëmijët të kuptojnë më mirë mendimet e njëri-tjetrit.
- Mësuesi duhet të përpiqet të gjejë zgjidhje kompromisi që t'i kënaqë të gjitha palët e përfshira në konflikt.
- Mësuesi duhet t'i nxitë nxënësit të gjejnë zgjidhje alternative.
- Mësuesi vetë duhet t'u paraqesë fëmijëve alternativa që ata të mund t'i zgjidhin.
- Mësuesi duhet të përpiqet që t'i mësojë fëmijët të kërkojnë falje.
- Mësuesi duhet t'i lejojë fëmijët të veprojnë ndaj konfliktit, por të jetë i kujdesshëm që fëmijët të mos cenohen nga ky proces.

Hapat e ndërmjetësimit

Pas kërkesës për ndërmjetësim, ndërmjetësi përcakton një plan pune në të cilin do të veçoheshin hapat e mëposhtëm:

- Mbledhja e informacionit;
- Takimi veçmas me palët e konfliktuara;
- Identifikimi dhe kontaktimi i personave që do të ndihmojnë në zgjidhje;
- Identifikimi dhe kontaktimi i personave që pengojnë procesin e ndërmjetësimit;
- Organizimi i seancës së ndërmjetësimit (përcaktimi i orarit, i vendit, i pjesëmarrësve);
- Zhvillimi i seancës e cila realizohet, duke mbajtur parasysh këto elementë:
 - Dëgjimi i ngjarjes nga të dyja palët,
 - Dëgjimi i propozimeve nga të dyja palët,
 - Sugjerimi i ndonjë zgjidhjeje tjetër të mundshme nga palët vetëm në rastet kur ndërmjetësi sheh që palët janë pranë kësaj zgjidhjeje,
 - Pajtimi i palëve,
 - Zgjidhja e konfliktit,
 - Nënshkrimi i aktmarrëveshjes,
 - Përfundimi i seancës ndërmjetësuese.

DREJTËSIA RESTAURUESE

Drejtësia restauruese mund të zbatohet para, gjatë ose pas procesit të gjyqimit të kundërvajtësit.



Tiparet kryesore të Drejtësisë restauruese:

- Drejtësia restauruese thekson mënyrat në të cilën krimi dëmton marrëdhëniet ndërmjet njerëzve që jetojnë në një komunitet.
- Drejtësia restauruese i jep viktimës së krimit më shumë mundësi për të marrë përsëri fuqinë e tyre personale duke shprehur nevojat e tyre.
- Drejtësia restauruese përfshin kundërvajtësit të marrin përgjegjësi vetjake për veprimet e tyre dhe pastaj punojnë për të riparuar dëmin që u kanë shkaktuar viktimave dhe komunitetit.

Avantazhet e përdorimit të Drejtësisë Restauruese

- I konsideron veprat penale në mënyrë më gjithëpërfshirëse: në vend të përkufizimit të krimit si shkelje ligji, ajo njeh që shkelësit dëmtojnë viktimat, komunitetet dhe madje veten e tyre.
- Përfshin më shumë palë: në vend të dhënies së roleve kryesore qeverisë dhe shkelësit, ajo përfshin viktimat, nëse duan dhe, gjithashtu, komunitetet.
- Mat suksesin ndryshe: në vend të matjes, sesa dënim është dhënë, ajo mat sa dëm është riparuar ose parandaluar.
- Njeh rëndësinë e përfshirjes dhe të nismës së komunitetit në përgjigjen ndaj krimit dhe reduktimin e tij, në vend që t'ia lërë problemin e krimit vetëm qeverisë.